



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr./Br.

Datë/Datum.

PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.13/21

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenkovic - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik “Eko Term” SH.P.K. & N.N.SH “Top Projekt” & “Lirim Bujari” B.I.-Suharekë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “NBT-Ing” SH.P.K.-Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi dhe Mirëmbajtja e Lapidarëve dhe Varrezave të Dëshmorëve-Faza e tretë përfundimtare” me nr. të prokurimit 624-20-5546-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Suharekë”, më datën: 08.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorëve ekonomik “Eko Term” SH.P.K.; & N.N.SH “Top Projekt” & “Lirim Bujari” B.I.-Suharekë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi dhe Mirëmbajtja e Lapidarëve dhe Varrezave të Dëshmorëve-Faza e tretë përfundimtare” me nr. të prokurimit 624-20-5546-5-2-1, iniciuar nga AK- KK-Suharekë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi dhe Mirëmbajtja e Lapidarëve dhe Varrezave të Dëshmorëve-Faza e tretë përfundimtare” me nr. të prokurimit: 624-20-5546-5-2-1, iniciuar nga AK-KK-Suharekë, dhe lënda kthehet në **rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorëve ekonomik ankues “Eko Term” SH.P.K.; & N.N.SH “Top Projekt” & “Lirim Bujari” B.I.-Suharekë, , aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatorët ekonomik ankues “Eko Term” SH.P.K.; & N.N.SH “Top Projekt” & “Lirim Bujari” B.I.-Suharekë, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 05.01.2021 me nr. 13/21, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi dhe Mirëmbajtja e Lapidarëve dhe Varrezave të Dëshmorëve-Faza e tretë përfundimtare” me nr. të prokurimit: 624-20-5546-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Suharekë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 56, 59, 60, 65, 66, 72, si dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 12.01.2021, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 13.01.2021,, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Pas shqyrtimit ne detaje te procedurës se tenderit si dhe shqyrtimit te pretendimeve ankimore te OE dhe dokumentacioni ne dispozicion te kësaj procedure te prokurimit eksperti shqyrtues jep këtë mendim:

Përgjigjen ne pretendimet ankimor Nr. 1 për Inxhinier (Bachelorin) e Gjeodezisë :

Autoriteti kontraktues ne njoftimin për kontratë te datës 23.09.2020 dhe Dosjes se Tenderit tek përcaktimi i kriterave kërkesat dhe dëshmitë i ka vendosur si ne vijim:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe professional: Kërkesa 2 - OE duhet të kenë staf të mjaftueshëm të punëtorëve dhe inxhinierëve të kyçur në projekt -Një (1) Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë (ose bachelor) me licence, minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit.	Dëshmia e kërkuar dokumentare Dëshmia 2 - Kontrata e punës ose marrëveshjet me inxhinierit, Diploma (dhe licenca për gjeodetin) e NOTERIZUAR dhe nga një CV.
---	-----------	---	--

Operatori ekonomik fitues i këtij tenderi (NBT ING SH.P.K) në dosjen e tenderit ka paraqitur Diplomën e Inxhinierit të Gjeodezisë me nr. VII – 4673 të datës 24.09.1999 të përfunduar në Universitetin e Zagrebit. Diploma është e noterizuar konform kërkesave të dosjes së tenderit, numri i noterizimit LRP nr. 1550/2017, po ashtu e njëjta është edhe e përkthyer në gjuhën Shqipe dhe është konform Nenit 13 të LPP-së. tenderit për Gjeodetin e prezantuar, Kontrata me nr.005r/109FSH e lidhur me datën 05/10/2020. OE. NBT „ING SHPK” ka prezantuar edhe Licencën me nr.44 e lëshuar me datën 24.08.2016 me validitet deri me dt. 22.08.2021 për Gjeodetin e prezantuar konform dosjes së tenderit. Po ashtu ka dorëzuar edhe CV konfirm kërkesës së Dosjes së tenderit. Andaj bazuar në kriteret e dosjes së tenderit AK nuk ka kërkuar që diplomat të jenë të notifikuara andaj Diploma e prezantuar nga ana e Operatorit ekonomik, “NBT ING SHPK” në këtë rast është konfirm Dosjes së tenderit andaj pretendimi ankimor në këtë pikë është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 2

Operatori ekonomik NBT ING SH.P.K ka plotësuar kriterin e dosjes së tenderit konkretisht Nenin 65 pasi që i njëjti ka dorëzuar Deklaratën Nën Betim – ANEKS 2, konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe Nenit 65 të LPP, andaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: ["NBT-ING" SHPK] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedure të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	"NBT-ING" SHPK
Adresa e plotë:	SUHAREKË
I përfaqësuar nga:	
Emri:	TAHIR SOPA
Pozita:	DREJTUES LIGJOR
Nënshkrimi:	
Data:	05.10.2020
Vula:	

Përgjigje ndaj pretendimit ankimor të pikës së anulimit të ofertës nga ana e AK:

AK, ka eliminuar operatorin ekonomik ankues „ Grupi i OE “EKO TERM” SH.P.K & N.N.SH “TOP PROJEKT”& “LIRIM BUJARI” B.I – Suharekë” sipas letrës standarde si në vijim: „ Tenderi juaj është refuzuar për këtë arsye: – i pa kompletuar nga se ju në paramasën e dhënë në ofertën tuaj në pozicionin 1.20 keni ofruar çmimin 0.00 i cili bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të RRUOPP” Lidhur me këtë AK me datën 07.12.2020 në bazë të LPP Nenit 72 dhe RROUP pikën 41.15 ku ka kërkuar informacion shtesë, sqarime shtesë nga ana e OE. NBT ING SH.P.K, OE ankues me datën 09.12.2020 ka dërguar sqarimet ndaj kërkesës së AK lidhur me vendosjen e çmimit 0.00 euro në pozicionin nr. 1.20 të paramasës së çmimeve. Paramasa e çmimeve e dërguar në ofertë nga ana e OE. Ankues:

kete lloj pune.					
1.18	Furnizimi punimi dhe montimi i ulesave nga konstruksioni beton arme, pjesa e uleses nga druri te montuara ne baze betoni sipas pershkrimit te projektit.	copë	2.00	80.00	160.00 €
1.19	Furnizimi dhe montimi i shportave per mbeturina te vendosura ne baze betoni me material alumin dhe mbeshtjellje druri te kualitetit te larte.	copë	3.00	40.00	120.00 €
1.20	Furnizimi dhe punimi i instalimit te ndriqimit publik, ne çmim te parashihen: hapja e kanalit (L=200m'), mbulimi sipas standardeve, fyteza, kablli e elektrik nga bakri i mjaftueshem per ndriqima (5 ndriques), shiriti per tokezim, shiriti sinjalizues, lidhjet e nevojshme, ormani komplet (1 cope) me te gjitha paisjet, nderprerresa fotorele, etj., lidhja ne furnizimin kryesore, si dhe testimi final deri ne kompletim. Gjatesia e perafert e rrjetit qe do te punohet eshte L=100m' Paguhet per komplet pozicionet.	komplet	1.00	0.00	0.00 €
1.21	Furnizimi , transporti dhe montimi dritave te parafabrikuara (ndriquesve). Ne llogari te perfshihet montimi i trupave ndriques si dhe testimi final, leshuarja ne veper.	copë	5.00	25.00	125.00 €
Total II=					12,981.00 €
TOTAL I+II=					95,450.00 €

Vërejtje: Në çmim të llogaritet edhe TVSH.



Andaj bazuar ne RROUP pikën 41.15 nën pikat 1 dhe 2 dhe bazuar ne paramasen e çmimeve te dërguara nga ana e OE ankues ku vërehet qartë se OE ka vendosur çmimin 0.00 euro në pozicionin 1.20 e që ne këtë rast është ne kundërshtim me RROUP pikën 41.15 , nën pikat 1 dhe 2 , AK ne këtë rast me eliminimin e ofertës se tyre ka zbatuar Nenin 59, 72 dhe RROUP pikën 41.15 nen pikat 1 dhe 2 andaj edhe ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke pasur parasysh sqarimet e lartcekura dhe bazuar ne zhvillimin e procedurës se prokurimit dhe dokumentacionit te ofertave dhe vlerësimit, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet, dhe njëkohësisht te mbetet ne fuçi vendimi i AK për dhënie te kontratës.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 14.01.2021 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 15.01.2021, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatorët ekonomik “Eko Term” SH.P.K.; & N.N.SH “Top Projekt” & “Lirim Bujari” B.I.-Suharekë, me datë 18.01.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 27.01.2021, nëpërmjet platformës elektronike ZOOM, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Eko Term” SH.P.K. & N.N.SH “Top Projekt” & “Lirim Bujari” B.I.-Suharekë, që ka të bëjë me inxhinierin e gjeodezisë, Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në njoftimin për kontratë të datës 23.09.2020 dhe dosjes se tenderit tek përcaktimi i kriterëve kërkesat dhe dëshmitë i ka vendosur si në vijim:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe professional: Kërkesa 2 - OE duhet të kenë staf të mjaftueshëm të punëtorëve dhe inxhinierëve të kyçur në projekt -Një (1) Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë (ose bachelor) me licence, minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit.	Dëshmia e kërkuar dokumentare Dëshmia 2 - Kontrata e punës ose marrëveshjet me inxhinierit, Diploma (dhe licenca për gjeodetin) e NOTERIZUAR dhe nga një CV.
---	-----------	--	---

Operatori ekonomik fitues i këtij tenderi (NBT ING SH.P.K) në dosjen e tenderit ka paraqitur diplomën e inxhinierit të gjeodezisë me nr. VII – 4673 të datës 24.09.1999 të përfunduar në Universitetin e Zagrebit. Diploma është e noterizuar konform kërkesave të dosjes se tenderit, numri i noterizimit LRP nr. 1550/2017, po ashtu e njëjta është edhe e përkthyer në gjuhën Shqipe dhe është konform Nenit 13 të LPP-së. tenderit për Gjeodetin e prezantuar, Kontrata me nr.005r/109FSH e lidhur me datën 05/10/2020. OE. NBT „ING SHPK” ka prezantuar edhe Licencën me nr.44 e lëshuar me datën 24.08.2016 me validitet deri me dt. 22.08.2021 për Gjeodetin e prezantuar konform dosjes se tenderit. Po ashtu, ka dorëzuar edhe CV konform kërkesës së Dosjes se tenderit. Andaj bazuar në kriteret e dosjes se tenderit AK nuk ka kërkuar që diplomat të jenë të notifikuar. Andaj, diploma e prezantuar nga ana e operatorit ekonomik “NBT ING SHPK” në këtë rast është konform dosjes së tenderit andaj pretendimi ankimor në këtë pikë është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar nenin 65 të LPP-së, Paneli Shqyrtues sqaron se AK duhet kërkojë sqarime nëse njëri anëtar i konsorciumit është në kundërshtim me nenin 65 të LPP-së.

Lidhur me pretendimin se AK e ka eliminuar operatorin ekonomik ankues “EKO TERM” SH.P.K & N.N.SH “TOP PROJEKT”& “LIRIM BUJARI” B.I – Suharekë” sipas letrës standarde si në vijim: „ Tenderi juaj është refuzuar për këtë arsye: – i pa kompletuar nga se ju në paramasën e dhënë në ofertën tuaj në pozicionin 1.20 keni ofruar çmimin 0.00 i cili bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të RRUOPP” Lidhur me këtë AK me datën 07.12.2020 ne bazë të LPP Nenit 72 dhe RROUP pikën 41.15 ku ka kërkuar informacion shtesë, sqarime shtesë nga ana e OE. NBT ING SH.P.K, OE ankues me datën 09.12.2020 ka dërguar sqarimet ndaj kërkesës se AK lidhur me vendosjen e çmimit 0.00 euro ne pozicionin nr. 1.20 të paramasës së çmimeve. Paneli Shqyrtues sqaron se në bazë të pikës 41.15 nën pikat 1 dhe 2 të RRUOPP-së dhe bazuar në paramasën e çmimeve të dërguara nga ana e OE ankues, ku vërehet qartë se OE ka vendosur çmimin 0.00 euro në pozicionin 1.20 e që në këtë rast është në kundërshtim me RROUP pikën 41.15, nën pikat 1 dhe 2. AK ne këtë rast me eliminimin e ofertës se tyre ka zbatuar nenin 59 dhe 72 të LPP-së, si dhe RROUP pikën 41.15 nën pikat 1 dhe 2. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka respektuar ne tërësi dispozitat e LPP-se. Andaj, obligohet AK që gjatë rivlerësimit të tenderëve të veproj në harmoni me të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të zbatoj në tërësi dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK “KK-Suharekë”;
- 1x1 OE “Eko Term” SH.P.K.; & N.N.SH “Top Projekt” & “Lirim Bujari” B.I.-Suharekë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.